



Pozita e namazit në Islam

Seid Bin Ali El Kahtani





Titulli në gjuhën arabe:

منزلة الصلاة في الإسلام

Autori: Seid bin Ali el Kahtani

Përktheu: Nexhat Ceka

Redaktura gjuhësore:

Përgaditja kompjuterike: Basri Ceka

Shtypi:

Tirazhi: 1000 copa.

Botimi i parë:

Boton:





Parathënie

Falënderimi i takon All-llahut. Atë e falënderojmë dhe prej Tij ndihmë dhe falje kërkojmë. Kërkojmë mbrojtje nga All-llahu prej të këqijave të vetvetes dhe të veprave tona. Kë e udhëzon All-llahu ska kush e lajthit dhe kë e largon nga rruga e vërtetë, ska kush e udhëzon. Dëshmoj se ska hyjni tjetër që meriton të adhurohet përveç All-llahut , i Cili është Një dhe dëshmoj se Muhammedi është rob dhe i dërguar i Tij, paqja dhe mëshira e Allahut qoftë mbi të, mbi shokët e tij dhe mbi gjithë ata që e ndjekin me mirësi deri në Ditën e Kijametit, më pas:

Në këtë broshurë të shkurtë “Pozita e namazit në Islam” jamë munduar ta shpjegoj shkurtimisht kuptimin e namazit, dispozitat, pozitën, veçoritë, dispozitën e lënësit të namazit dhe vlerën e namazit, duke u bazuar në argumentet e Kur’anit dhe Sunnetit.

Kam përfituar shumë nga mendimet mesatare të shejhut tonë shumë të vlerësuar Imamit Abdul Aziz bin Abdullah bin Baz, Allahu shpresojmë ta ngrit në grada të larta në Xhennetul Firdaus.

E lus Allahun që këtë punë të vogël ta bëj të bekuar, dhe të jetë e sinqertë për Të, dhe të më bëjë dobi gjatë jetës time dhe pas vdekjes, dhe të përfitoj ai që e lexon. Allahu

është i Vetmi që meriton të lutet dhe më Fisniku që shpresohet në Të, Ai na mjafton dhe vetëm tek ai mbështetemi dhe ska ndryshim e as fuqi pa ndihmën e Allahut. Salatet dhe selamet janë mbi të Dërguarin e fundit Muhammedin ρ , mbi familjen dhe shokët e tij dhe mbi të gjithë ata që e ndjekin me mirësi deri në Ditën e Kijametit.

Autori

E përfunduar paraditën e ditës së Xhuma më 18/8/1420 h.

1. Kuptimi i Es-Salah (namazit) në Islam

Kuptimi gjuhësor i fjalës Es-Salah.

Kuptimi i fjalës Es-Salah në gjuhën arabe është dua (lutje). Thotë Allahu Y në Kur'an:

خُذْ مِنْ أَمْوَالِهِمْ صَلَاةً تُطَهِّرُهُمْ وَتُزَكِّيهِمْ بِهَا وَصَلِّ لِيَهُمْ إِنَّ صَلَاتَكَ سَكَنٌ لَهُمْ وَاللَّهُ سَمِيعٌ عَلِيمٌ.

“Merr prej pasurisë së tyre (të atyre që pranuan gabimin) lëmoshë që ti pastrosh me të dhe tu shtosh (të mirat) dhe njëkohësisht lutu për ta, se lutja jote është qetësim për ta...”¹

Muhammedi ρ ka thënë: “Kur ndonjëri prej jush është ftuar, le ti përgjigjet ftesës, nëse është agjërueshëm le të **lutet**², në qoftë se nuk është i agjërueshëm le të hajë”³ do të thotë le të lutet për bereqet (mirësi) dhe falje.

Kurse Es-Salah prej Allahut Y. është lëvdata më e mirë, kurse prej melaikeve dua, thotë Allahu në Kur'an:

إِنَّ اللَّهَ وَوَلَائِكَتَهُ يُصَلُّونَ عَلَى النَّبِيِّ يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا صَلُّوا عَلَيْهِ وَسَلِّمُوا تَسْلِيمًا.

“Me të vërtetë All-llahu dhe engjëjt e Tij e mëshirojnë Pejgamberin ρ. O ju që keni besuar, çoni

¹ Suretu Teube, 103

² Lutet është përdorur në formën “Es-Salah”

³ Transmeton Muslimi,431

salavate mbi të (Muhammedin ﷺ) dhe përshëndeteni me salam”.¹

Thotë Ebu Ali: Salavati i Allahut është lëvdata e Muhamedit ﷺ tek melekët e Tij, kurse salavati i melekëve është dua.

Gjithashtu është thënë se fjala Es-Salah e ka kuptimin e rahmetit (mëshirës) prej Allahut Y dhe salah prej melekëve e ka kuptimin e Istigfarit (faljes).

Mendimi i vërtetë është mendimi i parë sepse Allahu Y thotë në Kur’an:

أُولَئِكَ عَلَيْهِمْ صَلَوَاتٌ مِنْ رَبِّهِمْ وَرَحْمَةٌ وَأُولَئِكَ هُمُ الْمُتَّقُونَ

“Të tillët janë ata që kanë bekime prej Zotit të tyre dhe mëshirë dhe të tillët janë ata të udhëzuarit”.²

Do të thotë se mbi ta ka lavdërim nga Allahu Y për ata dhe mëshirë, dhe ia ka bashkangjitur mëshirën salavatit dhe bashkangjitja do të thotë se ka dallim në kuptim.³

Pra Es-Salah është lëvdatë prej Allahut kurse prej krijesave (melekët, njerëzit dhe xhinët): kijam, ruku, sexhde, tesbih, dua. Kurse Es-Salah prej kafshëve e ka kuptimin e madhërimit të Allahut.

¹ Suretul Ahzab, 56

² Suretul Bekare, 157

³ Sherh Mumtie, Ibn Uthejmin 3/228.

Namazi në terminologjinë e sheriatit (legjislacio-nit Islam) nënkupton: “Ibadet (adhurim) për Allahun i përbërë prej fjalëve dhe punëve të caktuara të ditura, që fillon me tekbir dhe mbaron me selam. Dhe është quajtur Es-Salah (namaz) pasi që përmbledh në vete duat.

Pra salah është emërtimi i çdo duaje. Pastaj është emërtuar si dua e veçantë. Ose ka qenë emër i duasë pastaj është kthyer në namaz ligjor, sepse ka lidhje të ngushtë në kuptim ndërmjet duasë dhe namazit. Mirëpo kur cekët fjala salah (namaz) në sheriat nënkuptohet vetëm se namazi ligjor i njohur. Dhe gjithë namazi është dua:

Duaja mes’eleh: është kërkesa apo lutja që i bën dobi lutësit në kërkimin e dobisë ose largimin e të këqijave, dhe lutja i drejtohet vetëm Allahut i Cili është i Vetëm, me shprehje të mira lutëse.

Duaja si Ibadet (adhurim): Është kërkim i shpërblimit me vepra të mira siç janë kijami(qëndrimi në këmbë), ku’udi(ulja), rukuja, sexhdeja, dhe kush i vepron këto ibadetet vetëm se e ka lutur Zotin e tij dhe ka kërkuar prej Tij me shprehje të pëlqyera që ta fal atë. Pra ky është një sqarim i asaj se namazi është **dua mes’eleh dhe dua ibadet.**

2. Dispozita e Namazit

Namazi është farz (obligim) duke u bazuar në argumentet e qarta nga Kur’ani dhe hadithet e Pejgamberit ρ, dhe ixhmaja (pajtueshmëria) e gjith ummetit, për çdo musliman në moshën madhore (bilig), i mençur, pa përjashtim, përveç grave që janë në të përmuajshmet dhe në lehoni. Disa prej argumenteve të Kur’anit për obligimin e namazit janë:

وَمَا أُمِرُوا إِلَّا لِيُحْسِنُوا الصَّلَاةَ
وَيَذَرُوا الزَّكَاةَ وَذَلِكَ دِيَالِقَةٌ

“E duke qenë se ata nuk ishin të urdhëruar me tjetër, pos që ta adhuronin All-llahun me një adhurim të sinqertë ndaj Tij, që të largohen prej çdo besimi të kotë, ta falin namazin, të japin zekatin, se ajo është feja e drejtë.”¹

إِنَّ الصَّلَاةَ كَانَتْ عَمَلِي الْمُؤْمِنِينَ كِتَابًا بَاهِقُونَ

“... vërtetë namazi është obligim (në kohën e vet) i caktuar për besimtarët”².

Kurse prej Sunnetit mund të përmendim hadithin e Muadhrit τ kur Pejgamberi ρ e dërgoj atë në Jemen i tha: *Mësova atyre se Allahu ua ka bërë obligim pesë kohët e namazit Brenda çdo ditës dhe natës*³. Gjithashtu mund të

¹ Suretu Bejjine 5

² Suretu Nisa 103

³ Transmeton Buhari në kaptina obligimi i zekatit me numër 1395

cekim hadithin që transmetohet nga Ibn Umeri τ , se Pejgamberi ρ ka thënë: “Islami është ngritur mbi pesë shtylla: Dëshmia se nuk ka Zot që meriton të adhurohet përveç Allahut, dhe se Muhamedi është i Dërguari i Allahut, falja e namazit, dhënia e zekatit, agjërimi i Ramazanit, dhe shkuarja në haxh kush ka mundësi.¹

Prej Ubadete Ibn Samit transmetohet se e ka dëgjuar Pejgamberin ρ duke thënë: “Allahu ua ka obliguar pesë kohë të namazit robërve të Tij, dhe kush vjen me to duke mos lënë mangët diçka prej tyre dhe duke qenë se i ka kryer në mënyrë të mirëfillt, Allahu ka premtuar që atë person do ta fus në Xhennet.² Këto janë vetëm disa prej haditheve dhe ajeteve që flasin për obligueshmërinë e namazit kurse prej tyre ka edhe shumë të tjerë.

Kurse sa i përket Ixhmasë, janë pajtuar të gjithë dijetarët e umetit se pesë kohët e namazit janë obligim gjatë çdo dite dhe nate³. Dhe nuk është obligimpër gratë që janë në menstruacione dhe lehone duke u argumentuar me hadithin e Pejgamberit ρ : “A nuk është gruaja që nuk falet dhe nuk agjëron në menstruacione”⁴.

dhe Muslimi 1/50.

¹ Trans. Buhariu dhe Muslimi.

² Trans. Ebu Davudi 1420, Albani ka thënë se është sahih në “Sahih Sunnen Ebu Davud”

³ “El Mugni”, Ibn Kudame

⁴ Trans. Buhariu dhe Muslimi

3. Pozita e namazit në Islam

Namazi ka pozitë të lartë në Islam, dhe ajo që tregon për rëndësinë e madhe dhe pozitën e lartë të namazit është si vijon:

1. Namazi është shtylla e fesë, dhe nuk ngritet feja vetëm se me këtë. Në hadithin që transmetohet nga Muadhi, Pejgamberi ρ ka thënë: *“Baza e çdo çështje është Islami, dhe shtylla e saj është namazi dhe kulmi i saj është Xhiahadi(Lufta për hir të Allahut).*¹ Dhe kur rënohet shtylla rënohet edhe ajo çka është mbi të.

2. Është gjëja e parë për të cilën merret në pyetje robi, prej veprave të tij. Dhe gjith punët tjera i rregullohen ose i shkatrohen varësisht se a e ka namazn në rregul apo jo. Nga Enesi transmetohet se Pejgamberi ρ ka thënë: *“Gjëja e parë për të cilën llogaritet robi ditën e gjykimit është namazi, në qoftë se namazin e ka në rregull edhe punët tjera i ka në rregull, e në qoftë se namazin nuk e ka në rregull edhe punët tjera nuk i ka në rregull”.* Në një transmetim tjetër thuhet: *“Gjëja e parë që pyetet robi Ditën e Kijametit, shiqohet namazi i tij, nëse namazin e ka në rregull vetëm se ka shpëtuar, e në qoftë se nuk e ka në rregull, vetëm se ka humbur dhe është shkatruar”.*² Nga Temim Ed-Darij transmetohet se Pejgamberi ρ ka thënë: *“E para për të cilën*

¹ Trans. Tirmidhiu, Albani ka thënë se është hasen në librin “Irvau El-Galil”

² Trans. Taberani në “Esvat”

llogaritet robi Ditën e Kijametit është namazi i tij, në qoftë se e ka falur të plotë i shkruhet namazi i plotë, e në qoftë se nuk e ka plotësuar u thot Allahu melaikëve të Tij: shiqoni mos ka robi im namaze nafile që tia plotësoni farzin e tij, pastaj llogaritet zeqati në këtë mënyrë, pastaj llogariten të gjithë veprat tjera mbi llogaritjen e këtyre”.¹

3. Është gjëja e fundit që humbet prej fesë: Dhe kur të humbet gjëja e fundit e fesë nuk ngel diçka tjetër prej saj. Transmetohet prej Ebu Umames se Pejgamberi ρ ka thënë: *“Do të shkatrohen nyjet e Islamit, nyje pas nyje, çdo herë që shkatrohet një nyje, kapen njerëzit për atë që vin në rradhë. Gjëja e parë që humbet është Hukmi(Sheriati Islam), dhe e fundit është namazi”.*² Në një transmetim tjetër thuhet: *“Gjëja e parë që ngritet nga njerëzit është Emaneti(Besnikëria), dhe e fundit që ngel është namazi, dhe ndoshta ngel ndonjë që falet por nuk ka hajr në të”.*³

4. Porosia e fundit që Muhammedi ia la Ummetit të tij. Nga Ummu Selemeh τ transmetohet se ka thënë: Ka qenë porosi e fundit e Pejgamberit ρ : *“Namazin, namazin dhe atë që e keni në pronësi”*, derisa⁴

¹ Trans. Ebu Davudi, Shejh Albani ka thënë se hadithi është sahih në “Sahih El-Xhami`i”

² Trans. Ahmedî, Shejh Albani ka thënë se hadithi është sahih.

³ Trans. Taberiu në “Sagir”, Shejh Albani ka thënë se hadithi është hasen në “Sahih El-Xhami`i”

⁴ Trans. Ahmedî, Shejh Albani ka thënë se hadithi është sahih.

5. I lavdëron Allahu ata që e kryejnë namazin dhe që e urdhërojnë familjen e tyre në namaz: Thotë Allahu në Kur'an:

وَذَكَرَ فِي الْكِتَابِ إِسْمَاعِيلَ إِذْ نَزَّلْنَا صَاحِقَ الْوَعْدِ وَكَانَ رَسُولًا نَبِيًّا. وَكَانَ يَأْمُرُ أَهْلَهُ بِالصَّلَاةِ وَالزَّكَاةِ وَكَانَ عِنْدَ رَبِّهِ مَرْضِيًّا.

“Përkujtoju në këtë Libër Ismailin! Ai ka qenë shumë besnik (premtoi të bëhet kurban) dhe i dërguar, pejgamber. Ai urdhëronte familjen e vet me faljen e namazit dhe me zeqatë, dhe ishte te Zoti i tij i pranueshëm”.¹

6. I ka nënçmuar Allahu lënësit e namazit dhe ata që janë të shkujdesur ndaj namazit. Thotë Allahu në Kur'an:

فَخَلَفَ مِنْ بَٰعِثِهِمْ خَلْفٌ أَضَاعُوا الصَّلَاةَ وَاتَّبَعُوا الشَّهْوَاتِ فَسُوفَ يَلْمُوكُنَّ غَيًّا.

“E pas tyre (të mirëve) erdhën pasardhës të këqij, që e lanë namazin e u dhanë pas kënaqësive (trupore), e më vonë do të hidhen në çdo gjë të keqe (ose në Gaja)”.² Thotë Abdullah Ibn Mes’udi τ për “Gaja”: “Luginë në Xhehennem e thellë shumë dhe me shije të keqe”.³ Në një ajet tjetër thotë Allahu :

¹ Suretu Merjem 54,55

² Suretu Merjem, 59

³ Tefsir Ibn Kethir

لَنْ يُؤْمِنُوا فَمَا تَعْلَمُ إِنَّهُنَّ يَخَافُونَ اللَّهَ وَهُوَ خَائِفُهُمْ وَإِذَا قَامُوا إِلَى الصَّلَاةِ قَامُوا كُسَالَى
يُرَاءُونَ وَالنَّاسَ وَلَا يَذْكُرُونَ اللَّهَ إِلَّا قَلِيلًا.

“Munafikët përpiqen të mashtrojnë All-llahun (duke u paraqitur rrejshëm si besimtarë), por All-llahu mbizotëron dinakëritë e tyre. Ata edhe kur falen, falen me përtaci dhe vetëm sa për t’u dukur te njerëzit dhe fare pak e përmendin All-llahun”.¹

7. Shtylla më e rëndësishme e Islamit pas shehadetit: Nga Abdullah Ibn Amr τ transmetohet se Pejgamberi ρ ka thënë: *“Është ngritur Islami mbi pesë shtylla: Dëshmia se nuk ka Zot që meriton adhurimin përveç Allahut dhe se Muhamedi është i Dërguari i Tij, falja e namazit, dhënia e zekatit, agjërimi i Ramazanit, dhe shkuarja në haxh”*.²

8. Për rëndësinë e namazit tregon edhe fakti se nuk është bërë obligim në tokë, me ndërmjetësimin e Xhibrilit, por është bërë obligim pa ndërmjetësues Natën e Miraxhit mbi shtat kat qiej.

9. Fillimisht janë bërë obligim 50 kohëra të namazit, dhe kjo tregon për rëndësinë e namazit tek Allahu Y, pastaj Allahu Y e ka zvogëluar në pesë kohë ndaj robërve të tij brenda natës dhe ditës. Edhe pse pesë namaze janë obligim,

¹ Suretu En-Nisa, 142

² Mutefekun alejh (Trans. Buhariu dhe Muslimi).

vlera e tyre është sa 50 namaze, dhe kjo tregon për vlerën e madhe që ka namazi.

10. I ka numëruar Allahu në Kur'an punët e të shpëtuarve duke filluar me namazin dhe përsëri në fund me namaz. Thot Allahu :

قَدْ أَفْلَحَ الْمُؤْمِنُونَ. الَّذِينَ هُمْ فِي صَلَاتِهِمْ خَاشِعُونَ. وَالَّذِينَ هُمْ عَنْ اللَّغْوِ
مُعْذِرُونَ وَالَّذِينَ هُمْ لِمَلَائِكَةِ مَلَكَاتٍ فَاعْلَامُونَ. وَالَّذِينَ هُمْ لِمُؤْتَمِرِينَ حَافِظُونَ لَا عَلَى
أَزْوَاجِهِمْ أَوْ مَا مَلَكَتْ أَيْمَانُهُمْ فَإِنَّهُمْ غَيْرُ مَلُومِينَ فَمَنْ أَبْغَىٰ وَرَاءَ ذَلِكَ
فَأُولَئِكَ هُمُ الْعَادُونَ. وَالَّذِينَ هُمْ لِأَمَانَاتِهِمْ وَعَهْلِهِمْ رَاعُونَ. وَالَّذِينَ هُمْ عَلَىٰ
صَلَوَاتِهِمْ حَافِظُونَ.

” Është e sigurtë se kanë shpëtuar besimtarët. Ata të cilët janë të përrulur dhe janë të kujdesshëm gjatë faljes së namazit, dhe ata të cilët i shmangën të kotës (fjalë a punë), dhe ata të cilët rregullisht japin zeqatin, dhe ata të cilët e ruajnë nderin e vet (sa i përket jetës intime), me përjashtim ndaj grave të veta (me kurorë) dhe ndaj atyre (robreshave) që i kanë në pronësinë e vet, për të cilat nuk janë të qortuara, e kush kërkon përtej tyre (dëfrim nga të ndaluarat), të tillët janë ata që e kanë shkelë normat e caktuara, dhe ata të cilët me kujdes i ruajnë ato që u janë besuar (sende ose fjalë), e ruajnë

edhe premtimin e dhënë, dhe ata të cilët i kushtojnë kujdes kohës së namazit të tyre”.¹

11. Allahu Y e ka urdhëruar Muhamedin ρ dhe ndjekësit e tij që të urdhërojnë familjet e tyre për namaz. Ka thënë Allahu Y në Kur'an:

مُرَّاهَلِكِ وَالصَّلَاةِ وَاصْطَبِرْ ۚ عَلَیْهَا لَا نَسْأَلُكَ رِزْقًا نَحْنُ نَرْزُقُكَ وَالْعَاقِبَةُ
لَمَلَّتَقَى

“Urdhëro familjen tënde të falë namaz, dhe duro në kryerjen e tij(namazit), ngase ne nuk kërkojmë prej teje ndonjë furnizim (për ty as për familjen tënde), Ne të frnizojmë ty (dhe ata), ardhmëria e mirë është e të devotshmëve”.² Nga Abdullah bin Amr τ transmetohet se Pejgamberi ρ ka thënë: “Urdhëroni fëmijët e juaj për namaz kur janë 7 vjeç, ndërsa kur ti mbushin 10 vjet rihni për të(nëse nuk e falin namazin), dhe ndani ato në shtretër të vacant”.³

12. Është i urdhëruar ai që e ka zënë gjumi apo ai që ka haruar që ta plotëson (ta fal kaza) namazin, dhe kjo e përforcon vlerën e namazit. Nga Enes bin Malik τ transmetohet se Pejgamberi ρ ka thënë: “Kush harron të fal namazin, le ta fal kur ti kujtohet. Nuk ka shpagim tjetër

¹ Suretu El- Mu'minun (1-9).

² Suretu Ta ha 132

³ Transmeton Ebu Davudi, Shejh Albani ka thënë se hadithi është Sahih.

vetëm se ta fal atë”. Kurse në transmetimin e Muslimit thuhet: “Kush e harron namazin ose ka qenë duke fjetur gjatë kohës së namazit, shpagimi është që ta fal atëher kur ti kujtohet”.¹ Rregulla e atij që e zë gjumi merret për bazë edhe për atë që humb vetëdijen më pak se tre ditë, ky mendim transmetohet prej Amarit, Umran bin Husejn dhe Semrete bin Xhundub Allahu qoft i kënaqur me ta.² në qoftë se humbja e vetëdijes zgjat më shumë se tre ditë , atëherë nuk ibën kaza namazet e mbetura, sepse kjo i ngjan të çmendurit, dhe Allahu Y e din më së miri.³

¹ Mutefekun alejh

² “El Mugni” 2/52-55, Ibn Kudameh

³ “Mexhmua fetava” 2/457, Abdul Aziz bin Abdullah bin Baz

4. Veçoritë e namazit në Islam

Namazi dallohet prej punëve të tjera të mira duke u bazuar në:

1. Është emëruar prej Allahut Y si me fjalën Iman.
Thot Allahu Y në Kur'an:

.. وَمَا كَانَ اللَّهُ ضَيِّعًا بِمَا أَنْزَلْنَا إِلَيْكُمْ إِنَّ اللَّهَ لَبَلِيَّغٌ لِّرُؤُوفٍ رَّحِيمٍ.

“...dhe Allahu nuk ua humb imanin (besimin) tuaj, me të vërtetë Allahu është shumë i Butë dhe Mëshirues ndaj njerëzve”.¹ (fjala Iman në këtë ajet e ka kuptimin e namazit).D.m.th. namazin tuaj kah bejtul Makdis sepse namazi e vërteton veprën dhe fjalën e tyre.

2. E ka veçuar Allahu Y në të përmendur duke e dalluar prej të gjitha dispozitave tjera të Islamit. Thot Allahu në Kur'an:

اتْلُ مَا أُوحِيَ إِلَيْكَ مِنَ الْكِتَابِ وَأَقِمِ الصَّلَاةَ.

“Ti lexo atë që po të shpallet prej Librit (Kur'anit)”. Dhe leximi nënkupton ndjekjen dhe punën në atë që urdhëron Kur'ani prej dispozitave të fesë pastaj vazhdon: “**dhe fale namazin**”², pra namazi është veçuar në të përmendur prej dispozitave tjera. Në një ajet tjetër thot Allahu Y:

¹ Suretu El Bekare, 143.

² Suretul Ankebut, 45

وَأَوْحَيْنَا إِلَيْهِمْ فِعْلَ الْخَيْرَاتِ وَإِقَامَ الصَّلَاةِ .

”... dhe i orientuam në punë të mira dhe në faljen e namazit...”.¹ në këtë ajet namazi është cekur fillimisht prej veprave të tjera të mira, dhe ka shumë shembuj të ngjashëm si këta.

3. Është cekur shpesh në Kuran bashk me ibadetet tjera. Thot Allahu Y në Kur’an:

وَأَقِيمُوا الصَّلَاةَ وَآتُوا الزَّكَاةَ وَارْكَعُوا مَعَ الرَّاكِعِينَ

“Falni namazin dhe jepni zeqatin, dhe përluni (në ruku’) me ata që përlun”.²

فَصِّ لِّلرَّبِّكَ وَأَنحِرْ .

”Falu për Zotin tënd dhe prej kurban”.³

قُلْ إِنَّ صَلَاتِي وَنُسُكِي وَمَحْيَايَ وَمَمَاتِي لِلَّهِ رَبِّ الْعَالَمِينَ .

“Thuaj: “Namazi im, kurbanimi im dhe vdekja ime janë thjesht për All-llahun, Zotin e botëve”.⁴

4. E ka urdhëruar Allahu Y të Dërguarin e Tij ρ që të jetë i durueshëm në faljen e namazit. Thot Allahu Y:

¹ Suretul Enbija, 73

² Suretul Bekare, 43

³ Suretul Keuther, 2

⁴ Suretul En’am, 162

مَرَّ أَهْلُكَ بِالصَّلَاةِ وَأَصْطَبِرْ ۚ عَالِمِيهَا لَا نَسْأَلُكَ رِزْقًا نَحْنُ نَرْزُقُكَ وَالْعَاقِبَةُ لِلتَّقِي.

“Urdhëro familjen tënde të falë namaz, e edhe ti vetë zbatoje atë, ngase ne nuk kërkojmë prej teje ndonjë furnizim (për ty as për familjen tënde), Ne të frnizojmë ty (dhe ata) ardhmëria e mirë është e atij që ruhet”.¹, edhe pse Pejgamberi ρ ka qenë i urdhëruar që të jetë i durueshëm në çdo ibadet, duke u bazuar në fjalën e Allahu Y:

وَأَصْطَبِرْ ۚ لِعِبَادَتِهِ.

“...dhe bëhu i qëndrueshëm në ibadet (adhurim) ndaj Tij (Allahut)”.²

5. E ka bërë obligim Allahu Y namazin në çdo gjendje. Nuk ka arsyetim në lënien e namazit as i sëmuri, as i frikësuari, as udhëtari, apo diçka tjetër jasht kësaj. Mirëpo ndonjëherë bien disa kushte si lehtësim, si shkurtimi i numrit të rekateve ose disa veprimeve. Kjo përderisa ekziston vetëdija tek njeriu.

6. Allahu Y e ka bërë kusht që të falet në gjenfjen më të mirë. Prej saj është pastërtia (marrja e abdestit),

¹ Suretu Ta Ha, 132

² Suretu Merjem 65

veshja e rrobave të bukura, kthyerja kah Kibla, kushte të cila nuk janë obliguar në ibadetet tjera.

7. Vënia në veprim e shumicës së gjymtyrëve në kryerjen e namazit. Duke filluar prej zemrës, gojës, gjymtyrëve të trupit, gjë të cilën nuk mund ta hasim në ibadetet tjera.

8. Është e ndaluar gjatë faljes së namazit të meresh me diçka tjetër. Derisa edhe mendimet dhe pëshpëritjet dhe paramendimet.

9. Është pjesë prej fesë së Allahut të cilën e kanë banorët e qiellit dhe të tokës. Është çelësi i sherieve (legjislaturave) të Pejgamberëve, dhe nuk është dërguar ndonjë Pejgamber vetëm se me namaz.

10. I është bashkangjitur sidkut (vërtetësisë). Allahu Y thot në Kur'an:

فَلَا صَدَقَ وَلَا صَلَّى . وَلَكِنْ كَذَّبَ وَتَوَلَّى .

“E ai as nuk vërtetoi atë që duhej, as nuk u falë. Por përgënjeshtroi dhe ktheu shpinën”.¹ Pra veçoritë e namazit janë të shumta dhe nuk krahasohet diçka tjetër me të.²

¹ Suretul Kijameh 31,32.

² Shiço, “Sherh Mumti’a”, Ibn Uthejmin.

5. Dispozita e lënësit të namazit.

Braktisja e namazeve farze (të obligueshme), është kufër (dalje prej fesë), dhe kush nuk e fal namazin duke e mohuar obligueshmërinë e tij, bën kufër, kufër të madh me ixhmanë (pajtueshmërinë) e gjithë ulemave (dijetarëve), edhe në qoftë se e fal namazin (por e mohon atë).¹ Ai i cili e braktis namazin krejtësisht, mirëpo nuk e mohon obligueshmërinë e namazit, bën kufër, dhe mendimi më i sakt i dijetarëve është se kufri i tij është kufër i madh që personin e nxjerr nga Islami. Argumentet për këtë janë të shumta, shkurtimisht do ti paraqesim si vijon:

1. Thot Allahu Y në Kur'an:

يَوْمَ يَكْشَفُ عَنْ سَاقٍ وَيُدْعُو إِلَى السُّجُودِ فَلَا يَسْتِطِيعُ وَلَا يَشَاءُ
 أَبُو صَاهِمٍ رَضِيَ اللَّهُ عَنْهُ قَالَ وَقَدْ كَانُوا يَدْعُونَ إِلَى السُّجُودِ لَهُمْ سَالِحُونَ.

“(Përkujto) Ditën kur do të zbulohet kërciri (ditën e ringjalljes), e ata do të ftohen për të bërë sexhde (ata që janë besimtarë të gjithë do të bien me fytyrë në tokë para Allahut), por ata (hipokritët) nuk do të kenë mundësi. Shikimet e tyre janë të tmeruara dhe ata i kaplon poshtërimi, kur dihet se ata kanë qenë të ftuar të bëjnë sexhde sa ishin të shëndoshë (e ata - tallehin)”.² Dhe kjo

¹ “Tuhfetul Ihvan...”, Abdul Aziz bin Abdullah bin Baz, Allahu e mëshiroftë.

² Suretul Kalem 42,43.

“Ska dyshim se idhujtarët kriminelë, janë edhe në humbje dhe në zjarr të madh. Ditën kur me fytyrat e tyre do të tërhiqen zvarrë në zjarr. “Vuani dënimin e Sekarit”¹.

3. Dhe thotë Allahu i Madhëruar:

فَإِنْ تَابُوا وَأَقَامُوا الصَّلَاةَ وَآتَوُا الزَّكَاةَ فَأَإِخْوَانُكُمْ فِي الدِّينِ وَنُفُوسُهُمُ الْآيَاتِ لِتُبْعَثَ
يُعطون.

“Në qoftë se ata pendohen, e falin namazin dhe e japin zeqatin, janë vëllezër tuaj në fe. Ne sqarojmë agumentet për popullin që kuptojnë”². Pra është lidhur vëllezëria me besimtarët me veprën e namazit.

4. Transmetohet prej Xhabirit τ se e ka dëgjuar Pejgamberin ρ duke thënë” “Ndërmjet njeriut dhe ndërmjet shirkut (*Es-shirk*) dhe kufrit (*El kufir*) është lënia e namazit”³.

5. Transmetohet prej Abdullah bin Burejdetë se babai i tij ka thënë se i Dërguari i Allahu ka thënë: “*Premtimi i cili*

¹ Suretul Kamer, 47,48.

² Suretu Et-Teube, 11.

³ Transmeton Muslimi. Kaptina mbi thënien e fjalës kufër mbi ata që e lë namazin.

është në mes nesh dhe atyre është lënia e namazit dhe kush e lë atë ka bërë kufër".¹

6. Transmetohet nga Shekik bin Abdullah se ka thënë: “Shokët e Muhammedit ρ nuk e shihnin lënien e ndonjë vepre si kufër përveç namazit”.²

7. Transmetohet prej shumicës së ulemave Ixhmaja (pajtimi) i Sahabeve për kufirin e lënësit të namazit.³

8. Shejhul Islam Ibn Tejmijeh Allahu e mëshiroftë se lënësi i namazit bën kufër të madh duke u argumentuar në dhjetë metoda.⁴

9. Kurse Ibn Kajim Allahu e mëshiroftë ka cekur 22 argumente se lënësi i namazit bën kufër të madh.⁵ Dhe e vërteta është se lënësi i namazit në përgjithësi padyshim është qafir duke u argumentuar me këto argumente të qarta.⁶

¹ Transmeton Tirmidhiu, Nesaiu, Ibn Maxheh, dhe Hakimi që ka thënë se hadithi është sahih, me të cilën është pajtuar Dhehebiu.

² Transmeton Tirmidhiu, me zinxhir sahih.

³ Shiho “El Muhala” Ibn Hazmi 242,243, “Kitabu Salah” f.26 Ibn Kajim, dhe “Sherh Mumtiah ala Zadul Mustekni” Ibn Uthejmin2/28.

⁴ Shiho “Sherhul Umdeh”2/81-94 Ibn Tejmijeh.

⁵ Shiho “Kitabu Salah” Ibn Kajimit f. 17-26, ku ka cekur 10 argumente prej Kur’anit dhe 12 prej sunnetit dhe ixhmasë së sahabeve.

⁶ E kam dëgjuar Sheihun tonë Abdul Azizi bin Abdullah bin Baz duke e bërë qafir lënësin e namazit, edhe në qoftë se e len ndonjë vakt të namazit, edhe në qoftë se nuk e mohon obligimin e namazit.

10. Gjithashtu Ibn Kajimi ka thën: “ dhe tregon për kufrin e lënësit të namazit: Kur’ani, Sunneti dhe Ixhmaja e Sahabeve”.¹

¹ “Kitabu salah” Ibn Kajimit f. 17.

6. Vlera e namazit.

1. Namazi të largon nga të shëmtuarat dhe të iriturat. Thot Allahu Y në Kur'an:

تَلِّأَ أَمَا أُوحِي إِلَيْكَ مِنَ الْكِتَابِ وَأَقِمِ الصَّلَاةَ إِنَّ الصَّلَاةَ تَنْهَى عَنِ الْفَحْشَاءِ
وَالْمُنْكَرِ وَلَذِكْرِ اللَّهِ أَكْبَرُ وَاللَّهُ يَهْتَمُّ مَا تَصْنَعُونَ.

“Ti lexo atë që po të shpallet nga libri (Kur’ani), fal namazin, vërtet namazi largon nga të shëmtuarat dhe të iriturat, e përmendja e All-llahut është më e madhja (e adhurimeve); Allhu e di ç’punoni ju”.¹

2. Është vepra më e mirë pas dy Dëshmimeve. Transmetohet nga Abdullah Ibn Mes’ud τ i cili thot: E kam pyetur të Dërguarin e Allahut ρ: Cila vepër është më e mirë? Ai tha: “*Namazi në kohën e vet*”. Më pas i thash: Pastaj cila? Ai tha: “*Respektimi i prindërve*”. I thash pastaj cila. Ai tha: “*Xhihadi (lufta) në rrugën e Allahut*”.²

3. Pastrimi i mëkateve. Xhabiri transmeton se Pejgamberi ρ ka thënë: “*Shembulli i pesë kohëve të namazit, është sikurse shembulli i një lumi që rrjedh para derës së ndonjërit prej jush, në të cilin ai lahet pesë herë në dit*”.³

¹ Suretul Ankebut, 45.

² Mutefekun alejhi.

³ Transmeton Muslimi.

4. I mbulon të këqijat. Transmeton Ebu Hurejra τ se I Dërguari i Allahut ρ ka thënë: *“Pesë kohët e namazit, Xhumaja deri në Xhuma, Ramazani deri në Ramazan, i shlyejnë mëkatet ndërmjet tyre, në qoftë se largohet prej gjunaheve të mëdha”*.¹

5. Namazi është dritë në dunja dhe në ahiret për atë që e fal. Transmetohet nga Abdullah ibn Omeri se një ditë në prezencë të Pejgamberit ρ u përmend namazi dhe tha: *“Kush kujdeset për atë (namazin), atëherë namazi i tij i bëhet dritë, argument dhe shpëtim në Ditën e Gjykimit dhe kush nuk kujdeset për atë (namazin), ai nuk ka as dritë as argument as shpëtim, dhe në ditën e Kijametit do të jetë me Karunin, Fir’aunin, Hamanin dhe Ubej bin Halefin”*.² Dhe në hadithin e Ebu Musa el Eshariut transmetohet se Pejgamberi ρ ka thënë: *Namazi është dritë*.³

Dhe hadithi i Burejdes i cili transmeton se Pejgamberi ρ ka thënë: *“Përgëzime për ata të cilët ecin (shkojnë në xhami) në erësirë, me nurë (dritë) të plotë në ditën e Kijametit”*.⁴

6. All-llahu subhanehu ue teala i ngrit në grada të larta dhe ua shlyen mëkatet atyre që e e falin namazin.

¹ Transmeton Muslimi.

² Transmeton Ahmed, thotë Mundhiri se hadithi është sahih.

³ Transmeton Muslimi.

⁴ Transmeton Ebu Davudi, Shejh Albani ka thënë se hadithi është sahih.

Nga Theuban t transmetohet se Pejgamberit ρ ka thënë: *“Të porosis të bësh shumë sexhde, sepse ti nuk bën ndonjë sexhde për All-llahun vetëm se All-llahu ti ngren gradat me të dhe ti fshin gjunahet”*.¹

7. Namazi është prej shkaqeve më të mëdha të hyrjes në Xhennet dhe shoqërimi me Pejgamberin ρ në xhennet. Nga hadithi i Rebiatu ibn Kab el Eslemij i cili thotë: Fleta te i Dërguari i All-llahut subhanehu ue teala dhe ia solla një enë për të marrë abdest dhe për të kryer nevojën e tij dhe më tha: *“Kërko”!* I thashë: Kërkoj të jem shoku yt në xhennet. Ai më tha: *“A dëshiron diçka tjetër”?* Thashë: Jo, kjo është e gjitha. Ai më tha: *“Ndihmoi vetes tënde duke bërë shumë sexhde”*.²

8. Me ecjen për në namaz shkruhet vepër e mirë, ngriten gradat në Xhennet dhe shlyhen mëkatet. Nga Ebu Hurejra tarnsmetohet se i Dërguari i All-llahut ρ ka thënë: *“Kush pastrohet në shtëpinë e vet dhe pastaj shkon në një prej shtëpive të All-llahut për ta kryer një prej farzeve të All-llahut, për çdo hap që bën i shlyhet një mëkat, ndërsa hapi tjetër ia lartëson gradat”*.³

Kurse në një hadith tjetër thuhet. *“Kur merr abdest ndonjëri prej jush pastaj shkon në xhami, nuk e ngren*

¹ Transmeton Muslimi.

² Transmeton Muslimi.

³ Transmeton Muslimi.

*këmbën e djatht vetëm se i shkruhet nga Allahu Y një vepër e mirë për të, dhe nuk e ngre këmbën e majt vetëm se ia shlyen një të keqe atij”.*¹

9. I përgatitet gosti në Xhennet çdo herë që shkon në xhami qoftë herët apo vonë. Nga Ebu Hurejra τ transmetohet se Pejgamberi ρ ka thënë: *“Kush shkon në xhami herët apo vonë Allahu do ti përgatit atij banesa në xhennet, çdo herë që shkon herët apo von”.*² Përgatitja e banesës është sikur një banesë që përgatitet vetëm për miq.

10. Allahu Y if al mëkatet që person ii bën ndërmjet dy namazeve. Në hadithin që transmetohet nga Uthmani τ, ai thot se e ka dëgjuar të Dërguarin e Allahut ρ duke thënë: *“Nuk merr abdes ndonjë musliman dhe e merr abdestin në mënyrën më të mirë dhe e fal namazin vetëm se i falen gjunahet ndërmjet atij namazi dhe namazit paraprak”.*³

11. Namazi i shlyen mëkatet e mëparshme. *“Nuk e arrinë ndonjë musliman koha e namazit farz, dhe ai merr abdes ashtu siç është më mirë dhe e fal namazin me hushu (koncentrim të plotë) duke qenë i përkulur, vetëm se i shlyen*

¹ Transmeton Ebu Davudi.

² Mutefekun alejhi.

³ Transmeton Muslimi.

*mëkatet e mëparshme derisa nuk bën mëkate të mëdha, dhe kjo vlen vazhdimisht”.*¹

12. Melekët luten për atë person që e fal namazin, derisa ai qëndron në xhami, dhe konsiderohet se është në namaz derisa namazi e ndalon prej punëve tjera. Nga Ebu Hurejra transmetohet se Pejgamberi ρ ka thënë: *Namaz i njeriut me xhemat është më i vlefshëm se namazi i tijë në shtëpinë e tijë apo në teg njëzet e disa shkallë. Kështu kur ndonjëri prej jush merr abdes ashtu siç është më mirë pastaj vjen në xhami me të vetmin qëllim që ta fal namazin me xhemat, duke mos i interseuar asgjë tjetër përveç namazit, nuk bën ndonjë hap vetëm se i ngritet një gradë dhe i shlyhet nga një mëkat, derisa të hyjë në xhami, atëherë në namaz është aq sa e ka përfshirë namazi, dhe secilin prej jush e bekojnë melekët derisa gjendet në vendin ku është falë namazi, ata thonë: O Zot mëshiroje, o Zot fale, o zot pranoja pendimin. Engjëjt veprojnë kështu derisa njeriu të mos i mundoj të tjerët apo ta prish abdesin”.*²

13. Pritja e namazit llogaritet si përgatitja për në rrugë të Allahut. Nga Ebu Hurejra τ transmetohet se i Dërguari i Allahut ρ ka thënë: *“A doni të ju tregoj se me çka Allahu ua shlyen mëkatet dhe ua ngrit gradat tuaja? Po o i Dërguari i Allahut. Ai tha: “Marrja e abdestit kur është*

¹ Transmeton Muslimi.

² Mutefekon alejh.

vështirë, ecja e shpeshtë për në xhami, dhe pritja e namazit pas namazit, kjo është përgaditje për xhihad, kjo është përgaditje për xhihad”¹.

14. Shpërblimi i atij që del për të falur namazin është silurse shpërblimi i haxhiut që bën haxh. Ebu Umameh τ transmeton se i Dërguari i Allahut ρ ka thënë: *“Kush del prej shtëpisë së tij me abdes për të falur namazin farz, shpërblimin e ka si haxhiu. Dhe kush del për të falur namazin e duhasë dhe del vetëm për atë qëllim, e ka shpërblimin e atij që bën umre. Dhe namazi deri në namazin tjetër, ndërmjet të cilëve nuk fliten fjalë të kota, është në Librin Ilijinë (Libër që dëshmojnë Melekët për të)”².*

15. Kush shpejton për namaz dhe nuk e arrin e ka shpërblimin sikur me prezentu me xhemat. Nga Ebu Hurejra τ transmetohet se Pejgamberi ρ ka thënë: *“Kush merr abdes dhe e merr abdesin ashtu si është më mirë, pastaj shkon në xhami, dhe i sheh njerëzit se janë falur, Allahu Y atij personi ia jep shpërblimin sikur të atij personi*

¹ Transmeton Muslimi.

² Transmeton Ebu Davudi. Shejh Albani ka thënë se hadithi është i mirë.

që ka prezentu dhe e ka falur namazin (me xhemat) , nuk i pakësohet shpërblimi aspak”¹

16. Kur pastrohet dhe del për ta fal namazin është në namaz derisa të kthehet (në shtëpi)dhe i dhkruhet shpërblimi i shkuarjes dhe kthyerjes për në namaz. Nga Ebu Hurejra τ transmetohet se i Dërguari i Allahut ρ ka thënë: *“Kush merr abdes prej jush në shtëpinë e tij pastaj vjen në xhami, është në namaz derisa të kthehet. Dhe le të mos bën kështu. I gërshetoi gishtat ndërmjet tyre”²*. Gjithashtu nga Ebu Hurejra τ transmetohet se Pejgamberi ρ ka thënë: *“Kur del ndonjëri prej jush prej shtëpisë së tij deri në xhaminë time, njëri hap i shkruhet vepër e mirë kurse hapi tjetër ia shlyen një mëkat, derisa të kthehet”³*.

¹ Tranmeton Ebu Davudi, Shejh Albani ka thënë se hadithi është sahih.

² Transmeton Ibn Huzejmi dhe Hakimi, Shejh Albani ka thënë se hadithi është sahih.

³ Transmeton Hakimi, Ibn Hibani dhe Nesaiu. Shejh Albani ka thënë se hadithi është sahih.

Përmbajtja:

Parathënie.....	3
Kuptimi i Es-Salah (namazit) në Islam.....	5
Dispozita e Namazit.....	8
Pozita e namazit në Islam	10
Veçoritë e namazit në Islam.....	17
Dispozita e lënësit të namazit.....	22
Vlera e namazit.....	27